



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neneve 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 55-të, të mbajtur me datë 17.11.2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr. 12 - 2347 nga viti 2021 e formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i njohur, NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për faktin se lëndën në fjalë veprohet nga organ tjetër kompetent.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12 - 2347 nga viti 2021 është formuar në bazë të denoncimit me nr. 12 - 2347/1 datë 29.06.2021, dorëzuar në KSHPK nga një parashtruesi i njohur - ----- i cili i referohet kallëzimit penal kundër personit -----, Administrator falimentimi i "-----" ne falimentim, për shkak te keqpërdorimit te detyrës dhe autoritetit zyrtar dhe shoqërimit me person tjetër, dhe ----- nga -----, për organizimin dhe tjetërsimin e pasurisë së personit juridik të përmendur ku Kreditori më i madh ishte Ministria e Financave, e cila i shkaktoi dëm buxhetit të RMV-së dhe u mundësoi personave të mësipërm të përfitonin një përfitim të konsiderueshëm pasuror të kundërligjshëm.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve të denoncimit dhe konstatimit të gjendjes faktike, KSHPK-ja ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga Prokuroria Themelore Publike në Shkup lidhur me atë se a është parashtruar kallëzimi penal në fjalë në këtë prokurori, si dhe rezultatin e mundshëm të veprimit kompetent të prokurorisë ndaj të njëjtës. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të marrë ndaj lëndës së formuar, KSHPK-ja konstaton si në vijim:

- Me datë 19.08.2021, nga ana e një grupi të qytetarëve në Prokurorinë Themelore Publike Shkup u parashtrua kallëzim penal kundër -----, Administratorit të Falimentimit i "-----" në Falimentim dhe -----, pa deklaruar një krim specifik.

-Çështja në prokurori është regjistruar me KK nr.-----dhe pas kësaj nuk u mor vendim i prokurorit publik, sepse ishte rast i ri.

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se për rastin në lidhje me kallëzimin penal të parashtruar, është duke u zhvilluar procedurë pranë organit tjetër kompetent, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprimin e mëtutjeshëm të saj dhe ka vendosur si në dispozitë të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETЌOROR
PЌОR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska**

DorЌzuar deri te: Parashtruesi
Punoi: J.C.
Miratoi: M.r .SH.S, AnЌetar i KSHPK-sЌ



ДРЖАВНА КОМИСИЈА
ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
Претседател,
Билјана Ивановска